

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Metamorfoza e grave shqiptare mes shkëlqimit dhe degjenerimit/ Nga gruaja e familjes te Instagrami, luk si dhe jeta paralele Gazeta Shqip
ADRESA	https://gazeta-shqip.com/mendimi-im/metamorfoza-e-grave-shqiptare-mes-shkelqimit-dhe-deg-jenerimit-nga-gruaja-e-familjes-te-instagrami-luksi-dhe-jeta-paralele/
BURIMI	gazeta-shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 00:58:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 18:17:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8fb92ffed3a1e8c10db8a67be6632041d865019a83a9a3008b39f547c662353
TEKSTI	4b055ff41a3b4d3bb40a61393dc4e6f99728f4978852aed8249efd276a3e6919
PAMJA	ce0382b52d07452905f120a7fdb55af465e167b87cab4d421d77bef41236ae61

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2e26bd47ea5c663a553d667a257be5bef0a15c49edb86f705bac8471b5029ec6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f3a7f3b1840b8c1fdf37cf45c7cf9cf417896e420137132777a1bf295bf8fe5f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2e26bd47ea5c663a553d667a257be5bef0a15c49edb86f705bac8471b5029ec6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

MENDIMI IM

Metamorfoza e grave shqiptare mes shkëlqimit dhe degjenerimit/ Nga gruaja e familjes te Instagrami, luksi dhe jeta paralele

"Ajo çfarë ka degraduar në karakterin e disa vajzave shqiptare është përgjegjësia për t'u bërë nënë"

Kreshnik Spahiu



17:17 | 2 SHTATOR 2026

SHPERNDA ▾

Olena është një vajzë ukrainase, me sy të kaltër, inteligjente dhe nga femrat më të bukura që njoh. Ajo prej dy vjetësh është e dashuruar me Felix, një arkitekt shumë të pasur gjerman, i cili gjithashtu është shumë simpatik.

Dje, pas pune, e pashë Olenën duke qarë dhe e pyeta ç'ka ndodhur. Ajo u ul pranë meje dhe filloi të rrëfehej. Ishte shumë e zhgënjyer nga i dashuri, sepse në dy vjet nuk i kishte bërë asnjë dhuratë. Madje, edhe kur drekonin apo pinin kafe, e ndanin faturën: 2 euro kjo dhe 2 euro ai.

Heshta pak çaste dhe u përpoqa t'i kthej buzëqeshjen: "Olena, eja në Shqipëri, se nuk ke nevojë të punosh, sepse je e re dhe e bukur."

Mrekullisht, batuta funksionoi dhe ajo m'u kthye:

"Më trego, Kreshnik, për vajzat shqiptare, si janë dhe çfarë stili jete bëjnë?"

Unë buzëqesha dhe fillova tregimin tim për tipologjinë e gruas shqiptare:

Gratë shqiptare janë ndër më të bukurat në botë, por edhe shumë

inteligjente.

Nënë Tereza, Dua Lipa, Mira Murati, Ermonela Jaho, Inva Mula janë yje që i njeh gjithë bota.

36 vjet më parë, gratë ishin të paushqyera, të veshura keq, të lodhura nga puna e rëndë, bënë dush një herë në javë (të shtunën), por ishin Bio në fizionomi dhe pa asnjë ndërhyrje. Familja ishte shumë e fortë. Nëse një grua tradhtonte burrin, divorci bëhej me gjykim popullor në oborrin e pallatit, kur merrnin pjesë gjithë komshinjtë.

Vitet kaluan dhe tranzicioni shkatërroi familjen. Unë kam më shumë shoqe se shokë, sepse besoj thellësisht në vlerat e karakterit, miqësisë, përkushtimit dhe besës së grave shqiptare. Sot ka mijëra vajza dhe gra që punojnë me ndershmëri dhe kanë evoluar shumë lart në profesion.

*Por ka dhe mijëra gra që jetën e perceptojnë si telenovelë turke, duke fantazuar një të dashur me emrin Mesut, Ahmet, Emir, Yusuf.

*Por ka dhe vajza që jetën e perceptojnë në Instagram dhe ëndërrojnë një të dashur sportist apo artist duke ëndërruar pushime në Maldive.

*Por ka dhe vajza apo studente që preferojnë një burrë të martuar që u paguan qiranë e shtëpisë dhe mbajnë paralelisht 2-3 meshkuj të tjerë.

*Por ka dhe vajza që ulen çdo ditë në klube, jo vetëm nuk paguajnë kurrë por konsumojnë drogë po aq sa meshkujt e tyre.

*Por ka edhe vajza papunë që udhëtojnë një ditë në Venecia apo Paris vetëm për të publikuar 2 foto në Instagram, sepse gjithë fotot e tjera i kanë te pasqyra e ashensorit ose te pasqyra e WC-së të ndonjë lokali.

*Por ka dhe gra me dy fytyra që me shqiptarët janë shumë të ndershme, por tradhtojnë vetëm me burra të huaj, që mos merret vesh lidhja.

*Por ka dhe vajza që, kur ulesh në lokal, kanë një nivel më banal se burrat, me tre fjali:

- “Ja q*** robt atij.”
- “As më rruhet fare.”
- “O mashkull k** “

*Por ka dhe të tjera që shkojnë te parukierja, i thonë: më bëj një model flokësh që të shkojë me ngjyrën e makinës, se ma dhuroi dashnori.

*Por ka dhe zyrtare në administratë që jetojnë me qira, hanë fasule në darkë, por kur shkojnë në punë vishen vetëm firmato, me taka, me minifund, a thua se po shkojnë në sfilatë mode.

Por të gjitha këto mund t'i gjesh edhe në Ukrainë, e dashur Olena. Por ajo çfarë ka degraduar në karakterin e disa vajzave shqiptare është përgjegjësia për t'u bërë nënë. Ato e shohin burrin si portofol me euro, sepse edhe idiotët shqiptarë kështu i kanë mësuar femrat që dashuria blihet me para.

Në disa lagje të pasurish ka më shumë femra filipineze sesa shqiptare.

sepse shumica e grave përtojnë të rrisin fëmijët dhe punësojnë dy filipineze: një të shëmtuar si dado që u rrit kalamajtë dhe një të bukur që i bën masazh burrit. Shumë gra nuk divorcohen sepse ato bëjnë jetë paralele. Në shtëpi as nuk gatuajnë dhe as nuk pastrojnë. Ushqimi porositet me telefon, ndërsa për punë kanë një pastruse, që e përdorin dhe si spiune për lëvizjet e burrit. Mijëra prindër (burra-gra) të degeneruar po rrisin dhe edukojnë një brez të ri me trauma që kanë parë shturjen e nënës dhe babait.

Të zë tmerri kur je në aeroportin e Romës apo Athinës, tek gate i avionit për Tiranë. Shumica e nuseve të reja u flasin fëmijëve italisht apo greqisht. Gjuhën dhe traditën që nuk humbën arbëreshët për 600 vjet e humbën gratë e “demokracisë” për 600 ditë.

Por ti, Olena, kaq e bukur sa je, mos eja në Shqipëri, sepse do të kopjojnë edhe fytyrën. Ajo, pa u habitur, më pyeti pse.

Qesha dhe vazhdova: Në pallatin tim kam 5 vajza me fytyrë njësoj dhe unë të gjitha i thërras Bora, sepse ato kanë bërë kirurgji kozmetike për t'i ngjasuar një vajze të mrekullueshme dhe të famshme të showbiz-it. Gjysma e tyre kanë marrë lekë borxh për të plastikuar me silikon surratin, sepse ajo u ndryshon jetën.

Plasi e qeshura dhe unë u ndjeva mirë që ia ktheva buzëqeshjen mikeshës time nga Ukraina, të cilës i është vrarë e gjithë familja në luftë, por ishte e zhgënjyer nga i dashuri gjerman që nuk e qeraste as me kapuçino.

Pas gjithë kësaj historie, Olena duhet të zgjidhte nëse duhet të ndahej nga bukuroshi gjerman që ndante faturat kur drekonte apo të nisej drejt Tiranës për të gjetur një lac me kokën me 6 cepa, që javën e parë të dashurisë t'i dhurojë apartament në plazh, ndërsa javën e dytë t'ia mbushë Range Roverin me kokainë për transport shumice dhe pakice.

E përqafova miken time, duke i dhënë kurajo, dhe e këshillova të vazhdojë dashurinë e saj me dinjitet, por pa lëmoshë.

Mashkulli apo femra perfekte nuk ekziston.

Kjo është një tango nga e cila nuk mund të ndryshojë jeta jonë.

Nuk janë njerëzit apo sendet që ndryshojnë jetët tona, por qëllimet, pasionet dhe dashuria.

Më mirë barkun gjysmë bosh, por shpirtin plot.



GAZETA SHQIP

Rreth nesh
Marketing
Newsletter
Mundësi Punësimi
Kontakt

TOP ALBANIA RADIO

News
Shows
Video
Podcasts

MORE

Top Channel
TimeOutTirana
Top Music Awards

SOCIAL



Newsletter

[Regjistrohu](#)

[Privacy Policy & Terms of Use](#) | [Cookie Policy](#)

gazeta shqip

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.